



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Tiranë më 18.09.2018
Dokument parlamentar

R A P O R T

Mbi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (Europol), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014”

Drejtuar: Seancës Plenare

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës shqyrtoi në mbledhjen e datës 18.09.2018 në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “*Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (Europol), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014*”.

Qëllimi i projektligjit:

Projektligji ka për qëllim miratimin e amendimit të aneksit I të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, e cila është ratifikuar me ligjin nr.28/2014. Këto amendime janë propozuar në kuadër të ndryshimeve statutoire të Europol-it.

Objektivat kryesorë të marrëveshjes:

Në datën 1 maj 2017 ka hyrë në fuqi rregullorja e re e Europol-it dhe, si rrjedhojë, ka ndryshuar dhe kuadri i ligjor i saj. Kompetencat e Europolit do të mbulojnë krimin e organizuar, terrorizmin dhe format e tjera të krimeve të rënda, duke ndikuar mbi dy apo më

shumë shtete anëtare, në një mënyrë që të kërkojë një qasje të përbashkët nga shtetet anëtare, sipas shkallës, rëndësisë dhe pasojave të shkeljeve penale.

Format e krimit sipas amendimit të aneksit I të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL) janë:

- **terrorizmi,**
- **krimi i organizuar,**
- **trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike,**
- **aktivitetet e pastrimit të parave,**
- **krimi i lidhur me substancat bërthamore dhe radioaktive,**
- **kontrabandimi i emigrantëve,**
- **trafikimi i qenieve njerëzore,**
- **krimi i mjeteve motorike,**
- **vrasja dhe plagosja e rëndë trupore,**
- **tregtia e paligjshme e organeve dhe indeve njerëzore,**
- **rrëmbimi, pengmarrja dhe mbajtja e paligjshme e personave,**
- **racizmi dhe ksenofobia,**
- **grabitja dhe vjedhja në rrethana rënduese,**
- **trafikimi i paligjshëm në vlerat kulturore, duke përfshirë veprat antike dhe veprat e artit,**
- **mashtrimi dhe zhvatja,**
- **krimi kundër interesave financiare të Bashkimit Evropian,**
- **manipulimi i brendshëm dhe manipulimi i tregut financiar,**
- **shantazhi dhe zhvatja/shfrytëzimi,**
- **falsifikimi dhe pirateria e produkteve,**
- **falsifikimi i dokumenteve administrative dhe trafikimi me anë të atyre,**
- **falsifikimi i parave dhe i mënyrave të pagesave,**
- **krimi kompjuterik,**
- **korupsioni,**
- **trafikimi i paligjshëm i armëve, municioneve dhe eksplozivëve,**
- **trafikimi i paligjshëm i llojeve të kafshëve të rrezikuara,**
- **trafikimi i paligjshëm i llojeve dhe varieteteve të bimëve të rrezikuara**
- **krimi mjedisor, duke përfshirë ndotjen nga anijet,**
- **trafikimi i paligjshëm i substancave hormonale dhe i promovuesve të tjerë të rritjes,**
- **abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, duke përfshirë materialet abuzive dhe joshëse ndaj fëmijëve për qëllime seksuale,**
- **gjenocidi, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës.**

Projektligji do të kontribuojë për të rritur bashkëpunimin në luftën kundër formave të rënda të krimit ndërkombëtar, si dhe në kuadër të angazhimeve të ndërmarra nga Shqipëria për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit për luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Në nenin 25 të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, e cila është ratifikuar me ligjin nr.28/2014, është parashikuar që anekset e kësaj marrëveshjeje dhe dispozitat e nenit 3 (3) mund të ndryshohen përmes shkëmbimit të notave ndërmjet palëve.

Hyrja në fuqi :

Lidhur me hyrjen në fuqi të projekt marrëveshjes, kjo e fundit do të hyjë në fuqi pasi të ratifikohet me ligj dhe t'i dërgohet letra konfirmuese për hyrjen në fuqi të drejtorit ekzekutiv të Europol-it, duke pasur parasysh që sipas formulimit të letrës konfirmuese, marrëveshja hyn në fuqi me dërgimin e kësaj letrë nga pala shqiptare.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare duke vlerësuar rëndësinë e kësaj marrëveshje dhe përfitimeve të shumta që sjell në bashkëpunimin strategjik dhe operacional me zyrën e EUROPOL, me shumicën e anëtarëve miraton projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi si dhe shprehet dakord për kalimin e këtij pr/ligji në seancë plenare.

Kryetar /Relator

Ermonela (Felaj) VALIKAJ